

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 14 paragrafi 7 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja; dhe
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, me kapacitet të instaluar prej 9.9 MW, në lokacionin e fshatit Dobrushtë, komuna e Prizrenit, të datës 18.12.2014, të shoqërisë “Drini i Bardhë” SH.A., me adresë rruga “rruga “Vetim Shala” nr. 4, KK Prizren, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 20 shkurt 2015 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_492_2012 i datës 28 dhjetor 2012, edhe për një afat gjashtë (6) mujor, gjegjësisht **deri me 28 qershor 2015**.

A r s y e t i m

- o ZRRE, me datë 14.03.2011 nga shoqëria “Drini i Bardhë” SH.A., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, me kapacitet të instaluar prej 9.9 MW, në lokacionin e fshatit Dobrushtë, komuna e Prizrenit, Republika e Kosovës.
- o Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- o Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (2) dy vjeçar, dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqëria “Drini i Bardhë” SH.A., do t’i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- o ZRRE me datë 18.12.2014 nga shoqëria “Drini i Bardhë” SH.A., ka pranuar Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, me kapacitet të instaluar prej 9.9 MW, në lokacionin e fshatit Dobrushtë, komuna e Prizrenit, Republika e Kosovës, edhe për një afat shtesë sipas legjislacionit në fuqi.



- Shoqëria “Drini i Bardhë” SH.A., në kërkesë e saj ka sqaruar se që nga shtatori i vitit 2013 ende nuk kan pranaur përgjigje me shkrim nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik e republikës së Kosovës lidhur me vlefshmërinë juridike të Protokoll-Marrëveshjes së ujërave ndërkombëtar midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë dhe ish Republikës Federative të Jugosllavisë. Gjithashtu ka sqaruar se volumi i madh i përpunimit të të dhënave statistikore dhe disniveleve në Liqenin e Fierzës dhe prurjeve të ujit në këtë Liqen për ditët e 23 viteve me radhë të cilat cilat kanë sjellë për pasojë vonesën në fazën e përgatitjes së projektit final i cili pritet të përfundohet së shpejti. Andaj, ka sqaruar se këto dy çështje do të përfundohen së shpejti, dhe ka kërkuar shtyrje të afatit edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë.
- ZRRE pas analizimit të kërkesës për shlyerje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, ka vlerësuar ato dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

V. Shoqëria “Drini i Bardhë” SH.A., duhet të bëjë kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, me kapacitet të instaluar prej 9.9 MW, në lokacionin e fshatit Dobrushtë, komuna e Prizrenit, deri me datën **24 qershor 2014** duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.

VI. Pas skadimit të afatit të cekur më lartë, Vendimi V-492-2012 i datës 28 dhjetor 2012 mbi Njoftimi për Autorizimin Preliminar, do të shfuqizohet në mënyrë automatike, dhe nuk do të shqyrtohet nga Bordi i ZRRE-së.

VII. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.


VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare


Krenar Bujupi, anëtar